

EITI

KODI I ETIKËS

1. Qëllimi

Të gjithë anëtarët e bordit të EITI-t, zëvendësit e tyre, anëtarët e Asosacionit EITI, stafi i sekretariatit (kombëtar dhe ndërkombëtar) dhe anëtarë të grupeve multifunkionale (referuar më poshtë si "Përfaqësuesit e EITI-t) duhet të veprojnë në përputhje me këtë Kod Etike.

2. Sjellja personale, integriteti dhe vlerat.

Përfaqësuesit e EITI-t, duhet të zbatojnë standardet më të larta të integritetit dhe sjelljes etike dhe duhet të veprojnë me ndershmëri dhe drejtësi. Sjellja personale dhe profesionale e Përfaqësuesëve të EITI-t duhet gjithmonë të imponojë respekt dhe konfidencë për statusin e tyre si përfaqësues të EITI-t, një shoqëri promotore e standardeve ndërkombëtare për transparencë dhe llogaridhënie, si dhe duhet të kontribuojnë në një qeverisje të mirë të EITI.

Përfaqësuesit e EITI-t duhet të përkushtohen, të jenë shembull për të përfaqësuar interesin dhe misionin e EITI-t, me besim, ndershmëri, integritet, me kujdesin e duhur dhe kompetencë të arsyeshme në mënyrë që të rrisin besimin publik në integritetin e tyre dhe integritetin e EITI-t, si dhe të sigurojnë që marrëdhënia e tij/saj me EITI-n të mbetet gjithnjë në një pozitë të mirë.

3. Pajtueshmëria

Përfaqësuesit e EITI-t duhet të kryejnë detyrën e tyre në EITI, në përputhje me ligjet rregullat kombëtare, si edhe me interesat, objektivat dhe rregullat e EITI-t.

4. Respekti për të tjerët

Përfaqësuesit e EITI-t duhet të respektojnë dinjitetin, nevojat e lidhura me EITI-n dhe jetën private të të tjerëve, si dhe të ushtrojnë autoritet të mirëfilltë dhe gjykim të mirë në marrëdhënie me kolegët, anëtarët e stafeve të tjerë EITI, anëtarë të stafit, publikun në tërësi dhe ndaj kujt do me të cilin kanë kontakt gjatë kryerjes së detyrave të tyre në EITI.

5. Profesionalizmi

Përfaqësuesit e EITI-t duhet të realizojnë detyrat e caktuara në një mënyre profesionale dhe korrekte dhe duhet të përpiqen maksimalisht që të jenë pjesëmarrës të rregullt në aktivitetet e zhvillimit profesional.

6. Diskriminimi

Përfaqësuesit e EITI-t nuk duhet të përfshihen ose të lehtësojnë ndonjë sjellje diskriminuese ose ngacmuese në drejtim të kujt do që kontaktojnë gjatë punës së tyre në EITI.

7. Konfidencialiteti

Përfaqësuesit e EITI-t nuk duhet të përdorin dhe të bëjnë publik asnjë lloj informacioni që marrin si pasojë e rolit të tyre në EITI, me përjashtim të rasteve kur ky informacion është në mbështetje të detyrave dhe punës së tyre. Përfaqësuesit e EITI-t vazhdojnë ta kenë këtë detyrim dhe dy vjet pas përfundimit të mandatit të tyre në EITI.

8. Shpenzimet e burimeve EITI dhe përdorimi i pronës së EITI-t

Përfaqësuesit e EITI-t duhet të respektojnë parimin “vlerësim-për-paranë” dhe të jenë të përgjegjshëm në përdorimin e fondeve të dedikuara për EITI-n. Asnjë Përfaqësues i EITI-t nuk duhet të keqpërdor pronën apo burimet e EITI-t, por duhet ta mbaj gjithmonë të sigurt dhe nuk duhet të lejoj asnjë person të paautorizuar, ta marrë apo ta përdor këtë pronë.

Përfaqësuesit e EITI-t duhet të faturonjë vetëm kostot e udhëtimit, kostot operacionale apo kosto të tjera të lidhura me përmbushjen e detyrës si Përfaqësues të EITI-t.

Përfaqësuesit e EITI-t duhet të ofrojnë të mira ose shërbime me pagesë për EITI-n vetëm mbas një raportimi të plotë, dhe pas një miratimi paraprak nga Bordi EITI ose nga MSG-ja.

9. Konflikti i interesit dhe abuzimi me detyrën

Përfaqësuesit e EITI-t duhet të veprojnë gjithmonë në interes të EITI-t dhe jo për interesa dhe përfitime personale ose për pasurimin e tyre financiar.

Përfaqësuesit e EITI-t duhet të shmangin konfliktin e interesit privat. Për qëllim të këtij Kodi, një konflikt interesi është një situatë apo rrethanë në të cilën interesat e Përfaqësuesëve të EITI-t influencojnë ose mund të influencojnë performancën objektive dhe të paanshme në detyrat e tyre zyrtare për EITI-n. Në këtë kuadër, interesi privat përfshin çdo avantazh për veten, familjet e tyre ose për të njohurit personal.

Nëse Personat e Përfshirë në EITI e gjejnë veten në një situatë të tillë duhet të japin dorëheqjen dhe të informojnë Bordin e EITI-t ose MSG-në për dorëheqjen. Për Anëtarët e Bordit EITI aplikohen rregullat e caktuara në Nenin 5.6 të Statutit EITI.

Përfaqësuesit e EITI-t duhet të ndjekin veçanërisht këto direktiva:

- Të shmangët vendosja (dhe të shmangët shfaqja e vendosjes) e interesit vetjak ose interesi i një pale të tretë mbi interesin e EITI-t; ndërsa marrja aksidentale e një përfitimi personal ose përfitimi nga ana e një pale të tretë mundet të vijë nga disa aktivitete të EITI, përfitim i cili duhet të jetë thjesht aksidental përballë përfitimit primar të EITI-t dhe qëllimeve të tij. Çdo pagesë e vendosur, e paguar apo e marr duhet të bazohet në një kosto të arsyeshme aktuale dhe në një praktikë të mirë ndërkombëtare.¹
- Mos tejkaloni kompetencat që ju janë dhënë. Përfaqësuesit e EITI-t nuk duhet të abuzojnë me zyrën e EITI duke përdorur Shoqatën EITI ose stafin, shërbimet, pajisjet, burimet ose pronën e EITI-t për përfitime, për përfitime të palëve të treta ose për kënaqësi; Përfaqësuesit e EITI-t nuk duhet të përfaqësohen te palët e treta sikur autoriteti i tyre si Përfaqësuesit e EITI-t shtrihet më shumë se ç 'është aktualisht.
- Mos u angazhoni në ndonjë aktivitet personal të jashtëm i cili, në mënyrë direkt apo indirekte, mund të ndikoj negativisht nga ana materiale në EITI.

¹ Në përcaktimin e kostove aktuale të arsyeshme dhe të praktikave të mira ndërkombëtare, palët e interesuara mund të dëshirojnë të konsultojnë praktikën e Sekretariatit Ndërkombëtar. Kur Sekretariati ofron pagesa për shërbime (të cilat nuk i bëni stafi i tij), ai shpesh ndjek tarifën ditore të Departamentit të Shtetit Amerikan për të huajt http://aoprals.state.gov/content.asp?content_id=184&menu_id=81. Në përcaktimin e pagesave ditore sigurisht duhet të respektohen ligjet dhe rregulloret kombëtare.

10. Dhuratat, udhëtimet dhe zbavitjet

Përfaqësuesit e EITI-t nuk duhet të kërkojnë apo të pranojnë dhurata, bakshishe, udhëtime falas, honorare, prona personale ose çdo send tjetër me vlerë nga çfarëdolloj personi apo entiteti që kanë për qëllim të jenë, ose që në mënyrë të arsyeshme mund të të perceptohen të jenë, si një nxitje e drejtpërdrejtë apo e tërthortë për t'ju siguruar këtyre dhuruesve trajtim të veçantë në çështje që kanë të bëjnë me EITI-n.

Dhënia apo marrja e çfarëdo dhurate, udhëtimi falas ose kompensime të tjera që kalojnë shumën 100 USD të lidhura direkt apo indirekt me detyrat e EITI-t duhet ti deklarohen Bordit të EITI-t ose MSG-së përkatëse (nëpërmjet sekretariateve kombëtare ose ndërkombëtare). Çdo dhënie ose marrje dhuratash e konsideruar si e tepërt duhet të refuzohet. Në rastet kur dyshohet nëse një dhuratë është e tepërt, duhet të konsultohet Sekretariati EITI ose MSG-ja. Nëse do të jetë i papërshtatshëm refuzimi i një dhurate sepse refuzimi i saj do të krijonte siklet tek dhuruesi, dhurata duhet ti dorëzohet Sekretariatit EITI ose MSG-së.

11. Implementimi

Bordi i EITI-t, MSG-të përkatëse, sekretariatet kombëtare ose ndërkombëtare janë përgjegjës për t'i njohur Përfaqësuesit e EITI-t me këtë Kod Etike, si dhe për t'u ofruar, nëse është e nevojshme, trajnim rreth interpretimit dhe implementimin e tij. Ata persona, duke përfshirë këtu edhe MSG-të, që janë përgjegjës për prezantimin e Kodit të Etikës të Përfaqësuesit e EITI-t duhet të konfirmojnë çdo vit se Përfaqësuesit e EITI-t janë të familjarizuar me Kodin dhe të raportojnë rreth implementimit të tij te Bordi nëpërmjet Sekretariatit Ndërkombëtar.

12. Raportimi

Përfaqësuesit e EITI-t që kanë shqetësime në lidhje me interpretimin, implementimin ose me ndonjë shkelje potenciale të këtij Kodi Etike duhet ti sjellin këto çështje menjëherë në vëmendjen e strukturave të EITI-t. Kur çështje të tilla sillen në vëmendjen e Bordit EITI, Bordi do të marrë në konsideratë rrethanat dhe nëse veprimi është i nevojshëm dhe nëse është në përputhje me Parimet, Standardet e EITI-t, dhe me Nenet e Statutit. Cilido, i cili nuk ndihet rehat që ti ngrejë këto shqetësime me strukturat e EITI-t mund t'i sjelli këto shqetësime në vëmendje të Bordit të EITI-t nëpërmjet Komitetit qeverisës dhe kryetarit të tij.